



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR GJYKATËN KOMERCIALE<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON COMMERCIAL COURT<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O PRIVREDNOM SUDU<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Gjykatën Komerciale, është miratuar në mbledhjen e 16 - të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 04/16 të datës 22.06.2021.

<sup>2</sup> Draft Law on Commercial Court, was approved in the 16 - meeting of the Government of Republic of Kosova with the decision No: 04/16 dt: 22.06.2021.

<sup>3</sup> Nacrt Zakona o Privrednom Sudu, usvojenje na 16 - sednici Vlade Republike Kosova, odlukom Br: 04/16 dt: 22.06.2021.

<p><b>Kuvendi i Republikës së Kosovës;</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p><b>Miraton:</b></p> <p><b>LIGJ PËR GJYKATËN KOMERCIALE</b></p> <p><b>KAPITULLI I- DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i këtij ligji është themelimi, organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Komerciale në Republikën e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Fushëveprimi</b></p> <p>Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë personave juridik dhe fizik, përfshirë shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës të cilët kanë konteste ekonomike ndërmjet tyre.</p>	<p><b>The Assembly of the Republic of Kosovo;</b></p> <p>In accordance with article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p><b>Adopted:</b></p> <p><b>LAW ON COMMERCIAL COURT</b></p> <p><b>CHAPTER I- GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p> <p>The purpose of this law is to establish and regulate the organization and functioning of the Commercial Court of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Scope</b></p> <p>This law applies to all legal and natural persons in the Republic of Kosovo, including business organizations as defined in the Law on Business Organizations, in business disputes.</p>	<p><b>Skupština Republike Kosovo;</b></p> <p>U skladu sa članom 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p><b>Usvaja:</b></p> <p><b>ZAKON O PRIVREDNOM SUDU</b></p> <p><b>POGLAVLJE I -OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1</b> <b>Svrha</b></p> <p>Svrha ovog zakona je osnivanje, organizovanje i funkcionisanje Privrednog suda u Republici Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Delokrug</b></p> <p>Ovaj zakon se primenjuje na sva pravna i fizička lica, uključujući poslovna društva definisana u Zakonu o poslovnim društvima u Republici Kosovo koja imaju međusobne privredne sporove.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Juridiksioni</b></p> <p>1.Të gjitha kontestet lidhur me çështjet ekonomike dhe konfliktet administrative në konteste ekonomike janë në kompetencë të Gjykatës Komerciale.</p> <p>2.Gjykata Komerciale ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>3.Selia e Gjykatës Komerciale është në Prishtinë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 3 Jurisdiction</b></p> <p>1.All business and administrative disputes related to such commercial issues, initiated by business organizations fall within the jurisdiction of the Commercial Court.</p> <p>2.The Commercial Court has jurisdiction over the entire territory of the Republic of Kosovo</p> <p>3.The seat of the Commercial Court is in Prishtina.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 3 Nadležnost</b></p> <p>1.Svi poslovni i upravni sporovi koji proizilaze iz trgovackih sporova, koje pokreću poslovne organizacije spadaju u nadležnost Privrednog suda.</p> <p>2.Privredni sud je nadležan za celu teritoriju Republike Kosova</p> <p>3. Sedište Privrednog suda je u Prištini.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 4 Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. <b>Gjykata Themelore</b> - gjykatë e shkallës së parë, me seli në shtatë qendra rajonale gjeografike, që funksionon sipas dispozitave të Ligjit për Gjykatat.</p> <p>1.2. <b>Dega</b> - nëndarja gjeografike e një Gjykate Themelore, e themeluar me Ligjin në fuqi për Gjykatat.</p> <p>1.3. <b>Gjykata Komerciale</b> – Gjykatë e shkallës së parë dhe të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 4 Definitions</b></p> <p>1. Terms used in this Law shall have the following meanings:</p> <p>1.1. <b>Basic Court</b> - the court of first instance comprised of seven geographic areas as established by the Law on Courts.</p> <p>1.2. <b>Branch</b> - a geographical subdivision of a Basic Court, established by the applicable Law on Courts.</p> <p>1.3. <b>Commercial Court</b> – the First and Second Instance Chambers of this</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 4 Definicije</b></p> <p>1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. <b>Osnovni sud</b>- prvostepeni sud, sa sedištem u sedam regionalnih centara, koji funkcioniše prema odredbama Zakona o sudovima.</p> <p>1.2. <b>Ogranak</b>- geografski pododeljak Osnovnog suda, osnovan važećim Zakonom o sudovima.</p> <p>1.3. <b>Privredni sud</b>– Prvostepeni i drugostepeni sud, osnovan ovim</p>

<p>dytë, e themeluar me këtë ligj, kompetente për gjykimin e kontesteve për çështjet komerciale dhe administrative në çështje komerciale, si dhe trajton kundërshtimet dhe ankesat në procedurat përmbare, siç përshkruhet më tej në nenin 11 të këtij Ligji.</p> <p>1.4. <b>Gjykata e Apelit</b> - gjykatë e shkallës së dytë siç përcaktohet me Ligjin për Gjykatat.</p> <p>1.5. <b>Departament-nënkomponentë</b> e Gjykatës Komerciale, me qëllim të caktimit të lëndëve sipas natyrës së tyre, në mënyrë që të rritet efikasiteti i Gjykatës. Secili departament brenda Gjykatës Komerciale mban dhe ushtron të gjitha kompetencat e Gjykatës Komerciale siç përcaktohen në Nenin 13.</p> <p>1.6. <b>Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)</b> - institucioni i pavarur siç parashihet me Nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.</p> <p>1.7. <b>Kryetar i Gjykatës Komerciale</b> - gjyqtari përgjegjës për</p>	<p>court established by this Law, competent to adjudicate subject matter disputes of commercial and administrative disputes in commercial matters, as well as handle objections and appeals on the enforcement proceedings, as further described in Article 11 of this Law.</p> <p>1.4. <b>Court of Appeals</b> - the court of Second Instance as established by the Law on Courts.</p> <p>1.5. <b>Department</b> - a subcomponent of the Commercial Court established by this Law, for purposes of assigning cases according to subject matter in order to increase the efficiency of the courts. Each Department within the Commercial Court holds and exercises the full range of competencies of the Commercial Court as set out in Article 13.</p> <p>1.6. <b>Kosovo Judicial Council</b> - the independent institution as foreseen by Article 108 of the Constitution of the Republic of Kosovo.</p> <p>1.7. <b>President of the Commercial Court</b> - the judge responsible for the</p>	<p>zakonom, nadležan za suđenje sporova u privrednim i upravnim stvarima koje se ticu privrednih predmeta, kao i za rešavanje prigovora i žalbi u postupcima izvršenja, kako je dalje opisano u članu 11. ovog zakona.</p> <p>1.4. <b>Apelacioni sud</b> - drugostepeni sud, kako je definisano Zakonom o sudovima.</p> <p>1.5. <b>Odeljenje</b>- potkomponenta Privrednog suda koja se osniva ovim zakonom, u cilju dodeljivanja predmeta prema njihovoj prirodi kako bi se povećala efikasnost suda. Svako odeljenje unutar Privrednog suda zadržava i vrši sve nadležnosti Privrednog suda kako je utvrđeno u članu 13.</p> <p>1.6. <b>Sudski savet Kosova</b> – nezavisna institucija kako je predviđeno članom 108. Ustava Republike Kosovo.</p> <p>1.7. <b>Predsednik Privrednog suda</b>- sudija zadužen za upravljanje</p>
--	---	--

<p>menaxhimin e gjykatës dhe operimin e Gjykatës Komerciale, ashtu siç është paraparë me këtë ligj.</p> <p>1.8. <b>Akademia e Drejtësisë</b> - organi i pavarur, që vepron në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokuorial të Kosovës dhe institucionet e profesioneve juridike për koordinimin e nevojave për trajnim profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës, për trajnimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe çështje të tjera në pajtim me ligjin në fuqi për Akademinë e Drejtësisë.</p> <p>1.9. <b>Personat</b> - përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, termi “persona” nënkupton edhe persona fizik dhe juridik, përfshirë shoqëritë tregtare, si dhe çdo person që ushtron veprimtari afariste.</p> <p>1.10. <b>Shoqëritë Tregtare</b> - të gjitha shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.</p> <p>1.11. <b>Konteste tregtare</b> - çdo kontest mes shoqërive tregtare,</p>	<p>management and operations of the Commercial Court as provided by this Law;</p> <p>1.8. <b>Justice Academy</b> – the independent body, operating in cooperation with the Kosovo Judicial Council and Kosovo Prosecutorial Council and institutions of legal professions for coordination of needs for professional training of judges and prosecutors of Kosovo, for training of candidates for judges and prosecutors, as well as for other issues provided in the applicable law on the Justice Academy.</p> <p>1.9. <b>Persons</b> – unless expressly provided otherwise in this Law, the term “persons” means both natural and legal persons, including business organizations, as well as any person who engages in business activity</p> <p>1.10. <b>Business Organization</b> – all business organizations defined in the Law on Business Organizations.</p> <p>1.11. <b>Business Dispute</b> - any dispute between Business</p>	<p>sudom i funkcionisanje Privrednog suda, kako je predviđeno ovim zakonom;</p> <p>1.8. <b>Akademija pravde</b> - nezavisno telo, koje deluje u saradnji sa Sudskim savetom Kosova, Tužilačkim savetom Kosova i institucijama pravnih profesija, radi koordinacije potreba za stručnom obukom sudija i tužilaca Kosova, za obukom kandidata za sudije i tužioce, kao i druga pitanja u skladu sa važećim zakonom o Akademiji pravde.</p> <p>1.9. <b>Lica</b> – osim ako ovim zakonom nije izričito drugačije određeno, izraz „lica“ označava i fizička i pravna lica, uključujući poslovna društva, kao i svako lice koje obavlja poslovnu delatnost.</p> <p>1.10. <b>Poslovna društva</b> – sva poslovna društva utvrđena Zakonom o privrednim društvima.</p> <p>1.11. <b>Poslovni sporovi</b> - svi sporovi između poslovnih društava,</p>
---	---	--

<p>shoqërive tregtare dhe subjekteve publike dhe të gjitha konflikteve administrative të shoqërisë tregtare, siç përcaktohet në nenin 13 të këtij Ligji.</p>	<p>Organizations, Business Organizations and public entities and all administrative conflicts of Business Organizations as set forth in Article 13 of this Law.</p>	<p>poslovnih društava i javnih subjekata i svi upravni sporovi poslovnih društava iz člana 13. ovog zakona.</p>
<p><b>KAPITULLI II - PARIMET E PËRGJITHSHME</b></p>	<p><b>CHAPTER II - BASIC PRINCIPLES</b></p>	<p><b>POGLAVLJE II - OSNOVNA NAČELA</b></p>
<p><b>Neni 5</b> <b>Pavarësia dhe paanshmëria e Gjykatës Komerciale</b></p>	<p><b>Article 5</b> <b>Independence and Impartiality of the Commercial Court</b></p>	<p><b>Član 5</b> <b>Nezavisnost i nepristrasnost Privrednog suda</b></p>
<p>Gjykata Komerciale e themeluar me këtë ligj gjykon të gjitha çështjet në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin.</p>	<p>The Commercial Court established by this Law shall adjudicate all matters in accordance with the Constitution and the Law.</p>	<p>Privredni sud osnovan ovim zakonom presuđuje sve predmete u skladu sa Ustavom i Zakonom.</p>
<p><b>Neni 6</b> <b>Ushtrimi i kompetencave gjyqësore</b></p>	<p><b>Article 6</b> <b>The Exercise of Judicial Power</b></p>	<p><b>Član 6</b> <b>Vršenje sudskih nadležnosti</b></p>
<p>Kompetencat gjyqësore në Republikën e Kosovës ushtrohen nga gjykatat siç përcaktohet në Kushtetutën e Kosovës. Gjykata Komerciale, e themeluar me këtë ligj, ka kompetencë për çështjet lëndore nën juridiksionin e Gjykatës Komerciale siç përcaktohet në Nenin 13 të këtij ligji.</p>	<p>Judicial power in the Republic of Kosovo shall be exercised by the Courts as provided in the Constitution of Kosovo, whereas the Commercial Court established by this Law for subject matters under the jurisdiction of the Commercial Court as set forth in Article 13 below</p>	<p>Sudske nadležnosti u Republici Kosovo vrše sudovi kako je navedeno u Ustavu Kosova dok, Privredni sud osnovan ovim zakonom za predmetne slučajeve iz nadležnosti Privrednog suda kako je definisano u članu 13. u nastavku.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Përbërja e Gjykatës Komerciale</b></p> <p>Përbërja e Gjykatës Komerciale e ndjekë përbërjen e gjyqësorit në Kosovë dhe pasqyron diversitetin etnik të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht për barazi gjinore.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Composition of the Commercial Court</b></p> <p>The composition of the Commercial Court shall follow the composition of the judiciary in Kosovo and shall reflect the ethnic diversity of the Republic of Kosovo in accordance with the Constitution of Republic of Kosovo and internationally recognized principles of gender equality.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Sastav Privrednog suda</b></p> <p>Sastav Privrednog suda prati sastav pravosuđa na Kosovu i odražava etničku raznolikost Republike Kosovo, u skladu sa Ustavom Republike Kosovo i međunarodno priznatim načelima za rodnu ravnopravnost.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Vendimet e Gjykatës Komerciale</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendimet e gjykatës hartohen në formë të shkruar, në përputhje me ligjin.</li> <li>2. Vendimet e gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik.</li> <li>3. Gjykata publikon të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi. KGJK nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij neni.</li> </ol>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Decisions of the Commercial Court</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Court decisions are drafted in writing in accordance with the law.</li> <li>2. Court decisions are binding on all natural and legal persons.</li> <li>3. Courts shall publish all judgments on their official website, within sixty (60) days from the date of issuance of the judgment in accordance with the legislation in force. The Council issues sublegal acts for the implementation of this Article.</li> </ol>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Odluke Privrednog suda</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sudske odluke se izrađuju u pisanoj formi, u skladu sa zakonom.</li> <li>2. Sudske odluke su obavezujuće za sva fizička i pravna lica.</li> <li>3. Sudovi će objaviti sve presude na svojoj zvaničnoj veb stranici u roku od šezdeset (60) dana od dana donošenja presude u skladu sa važećim zakonodavstvom. Savet donosi podzakonske akte za primenu ovog člana.</li> </ol>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Qasja, Barazia dhe Transparenca në Gjykatën Komerciale</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Access, Equality, and Transparency of the Court</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Pristup, jednakost i transparentnost Privrednog suda</b></p>
<p>1. Gjykata Komerciale trajton të gjithë personat në mënyrë të barabartë, pa diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinioneve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, gjendjes sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ashtu siç përshkruhet në konventat ndërkombëtare.</p> <p>2. Çdo person ka qasje të barabartë në Gjykatën Komerciale dhe askujt nuk i mohohet e drejta e një procesi të rregullt gjyqësor, ose për mbrojtje të barabartë para ligjit. Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.</p> <p>3. Çdo person ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij, për aq sa veprimet për të mbrojtur ose zbatuar ato të drejta janë brenda kompetencave të Gjykatës Komerciale.</p> <p>4. Të gjitha seancat gjyqësore të Gjykatës Komerciale do të jenë të hapura për publikun</p>	<p>1. The Commercial Court shall treat all persons in an equal manner, without any discrimination based on race, color, gender, language, religion, political or other opinion, national or social origin, relation to any community, property, economic and social condition, sexual orientation, birth, disability or other personal status, as described in international conventions..</p> <p>2. All persons shall have equal access to the Commercial Court, and no one shall be denied due process of Law or equal protection of the Law. Every natural and legal person has the right to a fair trial within a reasonable timeframe.</p> <p>3. Every person has the right to address the Commercial Court to protect and enforce his o legal rights, insofar as actions to vindicate or enforce those rights are within the Commercial Court's competences</p> <p>4. All Commercial Court hearings shall be open to the public unless other laws expressly</p>	<p>1. Privredni sud tretira sva lica jednako, bez diskriminacije na osnovu rase, boje, pola, jezika, religije, političkog ili drugog mišljenja, nacionalnog ili društvenog porekla, veze sa nekom zajednicom, imovine, ekonomskog i socijalnog stanja, seksualnog opredeljenja, rođenja, invalidnosti ili drugog ličnog statusa, kako je propisano međunarodnim konvencijama.</p> <p>2. Svako lice ima ravnopravan pristup Privrednom sudu i nikome neće biti uskraćeno pravo na pravično suđenje ili jednaku zaštitu pred zakonom. Svako fizičko i pravno lice ima pravo na pravedno suđenje i u razumnom vremenskom roku.</p> <p>3. Svako lice ima pravo da se obrati Privrednom sudu da zatraži zaštitu i izvršavanje svojih zakonskih prava, ako su radnje zaštite ili ostvarivanja tih prava u nadležnosti Privrednog suda.</p> <p>4. Sve sudske rasprave Privrednog suda su otvorena za javnost, osim ako drugi zakoni</p>



<p>përveç nëse ligjet tjera shprehimisht përcaktojnë që çështjet e caktuara të mos zbulohen publikisht.</p> <p>5. Gjykata Komerciale do të funksionojë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen në kohë të kontesteve.</p> <p><b>KAPITULLI III- STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE KOMPETENCAT E GJYKATËS KOMERCIALE</b></p> <p><b>Neni 10</b> <b>Struktura organizative</b></p> <p>1. Gjykata Komerciale gjykon çështjet brenda kompetencës së saj në dhomat e shkallës së parë dhe dhomat e shkallës së dytë.</p> <p>2.Dhomat e shkallës së parë të Gjykatës Komerciale përbëhen nga katër (4) departamente të ndara, përfshirë Departamentin për Çështje Ekonomike, Departamentin Fiskal, Departmanetin për Çështje Administrative dhe Departamentin e Përgjithshëm.</p> <p>3.Në kuadër të Departamentit për çështje Ekonomike, funksionon Divizioni për</p>	<p>provide that certain matters not be publicly disclosed.</p> <p>5. The Commercial Court shall function in an expeditious and efficient manner to ensure the prompt resolution of disputes.</p> <p><b>CHAPTER III- ORGANIZATIONAL STRUCTURE AND COMPETENCIES OF THE COMMERCIAL COURT</b></p> <p><b>Article 10</b> <b>Organizational Structure</b></p> <p>1. The Commercial Court adjudicates matters within its competence in its First Instance Chambers and the Second Instance Chambers.</p> <p>2.The First Instance Chambers of the Commercial Court are composed of four (4) separate Departments, including the Economic Matters Department, the Fiscal Department, the Administrative Matters Department and the General Department.</p> <p>3.Within the Department for Economic Matters, shall operate a division for disputes</p>	<p>izriçito ne predviđaju da se pojedini slućajevi ne obelodane za javnost..</p> <p>5. Privredni sud će funkcionisati brzo i efikasno da bi obezbedio pravovremeno rešavanje sporova.</p> <p><b>III- POGLAVLJE III ORGANIZACIONA STRUKTURA I NADLEŽNOSTI PRIVREDNOG SUDA</b></p> <p><b>Član 10</b> <b>Organizaciona struktura</b></p> <p>1.Privredni sud rešava predmete iz svoje nadležnosti u prvostepenim i drugostepenim komorama.</p> <p>2.Prvostepene komore Privrednog suda sastoje se od četiri (4)odvojena odeljenja, uključujući Odeljenje za ekonomska pitanja, Fiskalno odeljenje, Odeljenje za administrativna pitanja i Generalno odeljenje.</p> <p>3.U Odeljenju za ekonomska pitanja, funkcionisaće odsek za strane investitore, sa</p>
---	---	---

<p>kontestet lidhur me investitorët e huaj, me juridiksion për tërë territorin e Kosovës. Gjyqtarët e emëruar në këtë Divizion, do të angazhohen edhe në departamentet tjera të Gjykatës, sipas nevojës.</p> <p>4.Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale vendosë në kolegjin e përbërë prej tre (3) gjyqtarëve.</p> <p>5.Kryetari i Gjykatës Komerciale, në bashkëpunim me gjyqtarët e Gjykatës, mund të vendosë për themelimin e divizioneve të specializuara në dhomat e shkallës së parë.</p> <p>6.Gjykata Komerciale ka një administrator, detyrat, rolet dhe funksionet e të cilit përcaktohen më tej në nenin 16 të këtij Ligji.</p> <p>7.Gjykata Komerciale ka një njësi të veçantë juridike, funksionet, organizimi dhe struktura e së cilës përcaktohen në Kapitullin V të këtij Ligji.</p>	<p>concerning foreign investors, with jurisdiction over the entire territory of Kosovo. Judges appointed to this Division will be engaged in other Departments of the Court, as needed</p> <p>4. The Second Instance Chamber of the Commercial Court decides in panels of three (3) judges.</p> <p>5.The President of the Commercial Court may decide to establish specialized divisions with the First Instance Chambers.</p> <p>6.The Commercial Court has one Administrator, whose duties, roles and functions are further defined in Article 16 of this Law.</p> <p>7.The Commercial Court has a separate Legal Unit, whose functions, organization, and structure are defined in Chapter V of this Law.</p>	<p>nadležnošću nad celom teritorijom Kosova. . Sudije imenovane u ovom odeljenju biće angažovane u drugim odeljenjima Suda, prema potrebi.</p> <p>4. Drugostepena komora Privrednog suda odlučuje u veću sastavljenom od tri (3) sudije.</p> <p>5. Predsednik Privrednog suda može odlučiti o osnivanju specijalizovanih odseka u Prvostepenim komorama.</p> <p>6. Privredni sud ima administratora, čije su dužnosti, uloge i funkcije dalje definisane u članu 16. ovog zakona.</p> <p>7. Privredni sud ima posebnu pravnu jedinicu, čije su funkcije, organizacija i struktura definisani u Poglavlju V ovog Zakona.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Dhomat e Shkallës së Parë</b></p> <p>1. Dhomat e Shkallës së Parë shqyrtojnë dhe gjykojnë rastet nga gjyqtari individual.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>First Instance Chambers</b></p> <p>1. The First Instance Chambers review and adjudicate cases by an individual judge.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Prvostepene komore</b></p> <p>1.Prvostepene komore razmatraju i presuđuju slućajeve od strane pojedinaćnih sudija.</p>

<p>2. Dhomat e Shkallës së Parë janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet në juridiksionin e Gjykatës Komerciale.</p> <p>3. Me pranimin e një parashtrere që e fillon një rast në Gjykatën Komerciale, Administratori i Gjykatës menjëherë ia cakton rastin Departamentit përkatës. Cilado palë që nuk pajtohet me caktimin e rastit në Departamentin përkatës mund të kundërshtojë dhe të kërkojë që rasti t'i transferohet një departamenti tjetër; por me kusht që çdo kundërshtim i tillë, nëse kërkohet, të parashtrohet në seancën e parë të thirrur për rastin. Nëse kërkesa nuk parashtrohet përbrenda afatit të caktuar, kërkesa për transferim të tillë të rastit mund të refuzohet pa mbajten e një seance për shqyrtimin e kërkesës. Palët mund të ankohen ndaj një urdhëri që lejon ose refuzon kërkesën për transferim të tillë të rastit.</p>	<p>2. The First Instance Chambers are competent to adjudicate in the first instance all cases within the jurisdiction of the Commercial Court.</p> <p>3. Upon receipt of a complaint or other document commencing a case in the Commercial Court, the Court Administrator shall immediately assign the matter to the appropriate Department. Any party objecting to that assignment may object and move that the case be transferred to another Department; provided however that any such objection shall be made, if all, at the first hearing convened on the case. If not timely made, such a motion may be denied without a hearing. An order granting or denying such motion is appealable.</p>	<p>2. Prvostepene komore su nadležne da presude u prvom stepenu o svim pitanjima iz nadležnosti Privrednog suda.</p> <p>3. Nakon prijema podneska kojim se pokreće slučaj u Privrednom sudu, administrator Suda će odmah dodeliti slučaj odgovarajućem Odeljenju. Bilo koja strana koja se ne slaže sa dodelom slučaja odgovarajućem Odeljenju može da uloži prigovor i zatraži da slučaj bude prosleđen drugom odeljenju; ali pod uslovom da se svaki takav prigovor, ako se zatraži, podnese u prvoj sudskoj raspravi sazvanoj za slučaj. Ako zahtev ne bude podnesen u zadanom roku, zahtev za takvo prenošenje slučaja može se odbiti bez održavanja rasprave za razmatranje zahteva. Stranke se mogu žaliti na nalog kojim se odobrava ili odbija zahtev za takav prenos slučaja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Dhomat e Shkallës së Dytë</b></p> <p>1. Dhomat e Shkallës së Dytë shqyrtojnë dhe gjykojnë rastet në kolegje të përbëra prej tre (3) gjyqtarëve.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Second Instance Chambers</b></p> <p>1. The Second Instance Chambers review and adjudicate cases in panels of three (3) judges.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Drugostepene komore</b></p> <p>1. Prvostepene komore razmatraju i presuđuju slučajeve u većima sastavljenim od tri (3) sudija.</p>

<p>2. Përbërja e kolegjeve në Dhomat e Shkallës së Dytë është në pajtim me obligimet ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.</p> <p>3. Vendimet e Dhomave të Shkallës së Dytë janë dokumente publike me vlerë të barabartë me vendimet e Gjykatës së Apelit. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron publikimin e vendimeve të Dhomave të Shkallës së Dytë në të njëjtën mënyrë siç publikon vendimet e Gjykatës së Apelit, siç parashikohet me Ligjin për Gjykatat. Vendimet e tilla, së paku, do të publikohen në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe i nënshtrohen rregulloreve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.</p>	<p>2. The composition of panels in the Second Instance Chambers is in accordance with the legal obligations set out in the applicable legislation.</p> <p>3. Decisions of the Second Instance Chambers are public documents of equal value to the decisions of the Court of Appeals. The Kosovo Judicial Council shall ensure the publication of decisions of the Second Instance Chambers in the same manner as it publishes the decisions of the Court of Appeals, as provided by the Law on Courts. Such decisions, at a minimum, shall be published on the website of the Kosovo Judicial Council and are subject to regulations of the Kosovo Judicial Council.</p>	<p>2. Sastav veća u drugostepenim komorama u skladu je sa zakonskim obavezama utvrđenim važećim zakonodavstvom.</p> <p>3. Odluke Drugostepenih komora su javna dokumenta jednake vrednosti odlukama Apelacionog suda. Sudski savet Kosova obezbediće objavljivanje odluka Drugostepenih komora na isti način na koji objavljuje odluke Apelacionog suda, kao što je predviđeno Zakonom o sudovima. Takve odluke će se najmanje objavljivati na veb stranici Sudskog saveta Kosova i podležu propisima Sudskog saveta Kosova.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Kompetencat e Gjykatës Komerciale</b></p> <p>1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë:</p> <p>1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, kontestet në mes të institucioneve publike dhe subjekteve private si dhe kontestet në mes të personave juridik vendor dhe të huaj, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Competences of the Commercial Court</b></p> <p>1. The Commercial Court is competent to adjudicate, and has exclusive jurisdiction to adjudicate, in its First Instance Chambers and Second Instance Chambers:</p> <p>1.1. disputes between local and foreign business organizations, as well as disputes between public and private legal persons, related to mutual business issues;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Nadležnosti Privrednog suda</b></p> <p>1. Privredni sud je nadležan da presudi i ima isključivu jurisdikciju za presudu u Prvostepenim i Drugostepenim komorama:</p> <p>1.1. sporovi između domaćih i stranih trgovačkih društava, sporovi između javnih institucija i privatnih lica, kao i sporovi između domaćih i stranih pravnih lica, u vezi sa međusobnim trgovinskim pitanjima;</p>

<p>1.2. prapësimet kundër urdhërave për përmbarrim për çështje brenda kompetencave të kësaj Gjykate;</p> <p>1.3. njohjen dhe lejimin e zbatimit të vendimeve të arbitrazhit vendor dhe ndërkombëtar;</p> <p>1.4. kontestet gjyqësore që rrjedhin nga Ligji në fuqi për Shoqëritë Tregtare;</p> <p>1.5. riorganizimi, falimentimi dhe shuarja e shoqërive tregtare;</p> <p>1.6. kontestet në lidhje me pengimin e posedimit në mes të shoqërive tregtare;</p> <p>1.7. kontestet në lidhje me pasuritë e paluajtshme të shoqërive tregtare;</p> <p>1.8. kontestet që lidhen me shkeljen e konkurrencës, keqpërdorimit ose monopolit dhe pozitës dominuese në treg, si dhe marrëveshjet monopole duke përfshirë vlerësimin e paligjshmërisë;</p>	<p>1.2. reversals against writs of enforcements on issues falling under the competences of this Court;</p> <p>1.3. recognizing and allowing the enforcement of local and international arbitration awards;</p> <p>1.4. court disputes arising from the applicable Law on Business Organizations;</p> <p>1.5. reorganization, bankruptcy and termination of business organizations;</p> <p>1.6. disputes concerning obstruction of possession between business organizations,</p> <p>1.7. disputes concerning immovable property of business organizations;</p> <p>1.8. disputes related to the violation of competition, misuse or monopoly and the dominant position in the market as well as monopoly agreements including the assessment of illegality;</p>	<p>1.2. odbacivanje naredbe za izvršenje u slučajevima iz nadležnosti ovog Suda;</p> <p>1.3. prepoznavanje i omogućavanje sprovođenja lokalnih i međunarodnih arbitražnih odluka;</p> <p>1.4. sudski sporovi koji proizilaze iz važećeg Zakona o poslovnim društvima;</p> <p>1.5. reorganizacija, stečaj i likvidacija poslovnih društava;</p> <p>1.6. sporovi u vezi sa ometanjem posedovanja između poslovnih društava;</p> <p>1.7. sporovi u vezi sa nekretninama poslovnih društava;</p> <p>1.8. sporovi vezani za kršenje konkurencije, zloupotrebe ili monopola i dominantnog položaja na tržištu, kao i monopolski sporazumi, uključujući procenu nezakonitosti;</p>
---	--	---

<p>1.9. mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe pronësisë industriale, përfshirë markat tregtare, patentat, dizajnet industriale, sekretet tregtare dhe format e tjera të pronësisë industriale, siç parashihet nga legjislacioni përkatës;</p> <p>1.10. kontestet ndërmjet kompanive të aviacionit që i nënshtrohen Ligjit për Aviacionin, duke përjashtuar kontestet në lidhje me të drejtat e pasagjerëve;</p> <p>1.11. kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore;</p> <p>1.12. kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve që lidhen me lejet, licencat ose çdo autorizim nën autoritetin e një organi publik të Republikës së Kosovës, përfshirë njësitë e vetëqeverisjes lokale;</p>	<p>1.9. protection of copyright and industrial property rights, including trademarks, patents, industrial design, commercial secrets and other forms of industrial property as foreseen by relevant legislation;</p> <p>1.10. disputes between aviation companies subject to the Law on Aviation, excluding disputes concerning passenger rights;</p> <p>1.11. administrative disputes initiated by business organizations against the final decisions of Tax Authorities, Customs Authorities, Ministry of Finance and any other public body in charge of imposing taxes or other state duties;</p> <p>1.12. administrative disputes initiated by business organisations against decisions relating to permits, licenses or any authorization under the authority of a public body of the Republic of Kosovo, including local self-government units;</p>	<p>1.9. zaštitu autorskih prava i industrijske svojine, uključujući trgovačke marke, patente, industrijske dizajne, poslovne tajne i druge oblike industrijske svojine, kako je predviđeno odgovarajućim zakonodavstvom;</p> <p>1.10. sporovi između vazduhoplovnih kompanija koje podležu Zakonu o vazduhoplovstvu, isključujući sporove u vezi sa pravima putnika;</p> <p>1.11. upravni sporovi koje pokreću poslovna društva protiv konačnih odluka poreske administracije, carinskih organa, Ministarstva finansija i bilo kojeg drugog javnog organa odgovoran za uvođenje poreza ili drugih državnih dažbina;</p> <p>1.12. administrativni sporovi koje kompanije pokreću protiv odluka vezanih za dozvole, licence ili bilo kakva ovlašćenja iz nadležnosti javnog organa Republike Kosovo, uključujući jedinice lokalne samouprave;</p>
---	---	---

<p>1.13. çështje të tjera siç mund të parashikohen me ligj.</p> <p>2. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike.</p> <p>3. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.6, 1.7, 1.8, 1.10 dhe 1.13 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti i Përgjithshëm;</p> <p>4. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal;</p> <p>5. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Administrative.</p> <p>6. Dhomat e shkallës së dytë janë kompetente për të trajtuar:</p> <p>6.1. të gjitha ankesat ndaj vendimeve të dhomave të shkallës së parë brenda kompetencave të</p>	<p>1.13. other cases as may be provided by law.</p> <p>2. All matters listed within sub-paragraphs 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 and 1.9 of paragraph 1 of this Article shall be handled in First Instance by the Economic Matters Department.</p> <p>3. All matters listed within sub-paragraphs 1.6, 1.7, 1.8, 1.10 and 1.13 of paragraph 1 of this Article shall be handled in First Instance by the General Department;</p> <p>4. All matters listed within sub-paragraph 1.11 of paragraph 1 of this Article shall be handled in First Instance by the Fiscal Department.</p> <p>5. All matters listed within sub-paragraph 1.12 of paragraph 1 of this Article shall be handled in First Instance by the Administrative Matters Department.</p> <p>6. The Second Instance Chambers are competent to review:</p> <p>6.1. all appeals from decisions of the First Instance Chamber within the competences listed in paragraph 1 of this Article;</p>	<p>1.13. druga pitanja koja su zakonom propisana.</p> <p>2. Sva pitanja utvrđena iz tačaka 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 i 1.9 stava 1. ovog člana biće razmatrana u prvom stepenu od Odeljenja za ekonomska pitanja.</p> <p>3. Sva pitanja utvrđena iz tačaka 1.6, 1.7, 1.8, 1.10, 1.12. i 1.13. stava 1. ovog člana biće razmatrana u prvom stepenu od Generalnog odeljenja;</p> <p>4. Sva pitanja utvrđena u tački 1.11. stava 1. ovog člana biće razmatrana u prvom stepenu od Fiskalnog odeljenja.</p> <p>5. O svim pitanjima navedenim u podstavu 1.12 stava 1. ovog člana, prvostepeno će se baviti Odeljenje za administrativna pitanja</p> <p>6. Drugostepene komore su nadležne za razmatranje:</p> <p>6.1. svih žalbi na odluke prvostepenih komora u okviru nadležnosti iz stava 1. ovog člana;</p>
---	--	---

<p>përmendura në paragrafin 1 të këtij neni;</p> <p>6.2. të gjitha ankesat ndaj një urdhëri për transferimin, apo refuzimin për transferim, të një rasti brenda departamenteve të shkallës së parë, që janë parashtruar brenda afatit të caktuar;</p> <p>6.3. konfliktet e juridiksionit nga dhomat e shkallës së parë dhe gjykatat themelore të Kosovës; dhe</p> <p>6.4. çështjet tjera siç mund të parashikohen me ligj.</p>	<p>6.2. all appeals of an order transferring, or refusing to transfer a case from one First Instance Department on the timely motion of a party;</p> <p>6.3. conflicts of jurisdiction from First Instance Chambers and Basic Courts of Kosovo; and</p> <p>6.4. other matters as may be provided by Law.</p>	<p>6.2. svih žalbi protiv naredbe za prenos ili odbijanja prenosa predmeta unutar odeljenja prvog stepena koje su podnete u propisanom roku;</p> <p>6.3. sukoba nadležnosti od strane Prvostepenih komora i Osnovnih sudova Kosova; i</p> <p>6.4. ostala pitanja koja su zakonom propisana.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Mjetet e Jashtëzakonshme Juridike</b></p> <p>1. Lidhur me kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës zbatohen ligjet procedurale në fuqi.</p> <p>2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, revizioni lejohet në kontestet me kusht që vlera e kontestit të jetë jo më pak se 50.000 (pesëdhjetë mijë Euro).</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Extraordinary Legal Remedies</b></p> <p>1. Regarding requests for extraordinary legal remedies against the final decisions of the Commercial Court of the Republic of Kosovo, the applicable procedural laws apply.</p> <p>2. Notwithstanding paragraph 1 of this Article, revision is allowed provided that the value of the dispute is no less than 50.000 (fifty thousand Euros).</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Vanredni pravni lekovi</b></p> <p>1. Što se tiče zahteva za vanrednim pravnim lekovima protiv konačnih odluka Privrednog suda Republike Kosovo, primenjuju se važeći proceduralni zakoni.</p> <p>2. Izuzetno od stava 1 ovog člana, revizija je dozvoljena u sporovima pod uslovom da vrednost spora nije manja od 50.000 (pedeset hiljada evra).</p>



<p>3. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk lejohen për kontestet që trajtohen nga Gjykata Komerciale.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Emërimi i gjyqtarëve dhe kryetarit të gjykatës komerciale</b></p> <p>1. Kandidatët për emërim si gjyqtar sipas nenit 104 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet të plotësojnë kushtet minimale si në vijim:</p> <p>1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2. të ketë diplomë të vlefshme të fakultetit juridik që njihet nga ligjet e Kosovës;</p> <p>1.3. të ketë të kryer provimin e jurisprudencës të njohur sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë;</p> <p>1.4. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal;</p> <p>1.5. të mos jenë dënuar për veprë penale, të definuar sipas ligjeve në fuqi;</p>	<p>3. With the exception to paragraph 1 of this article, requests for protection of legality are not allowed for disputes handled by the Commercial Court.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Appointment of Commercial Court Judges and the Court President</b></p> <p>1. Candidates for appointment as a judge under Article 104 of the Constitution of the Republic of Kosovo shall meet the following minimum qualifications:</p> <p>1.1. be a citizen of Kosovo;</p> <p>1.2. have a valid university degree in Law recognized by the Laws of Kosovo;</p> <p>1.3. have passed the bar examination recognized by the applicable laws of Kosovo;</p> <p>1.4. have high professional reputation and moral integrity;</p> <p>1.5. not have been convicted of a criminal offense, defined by applicable Law;</p>	<p>3. Izuzetno iz stava 1. ovog člana, zahtevi za zaštitu zakonitosti nisu dozvoljeni u sporovima koje rešava Privredni sud.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Imenovanje sudija Privrednog suda</b></p> <p>1. Kandidati za imenovanje kao sudije u skladu sa članom 104. Ustava Republike Kosovo moraju da ispunjavaju sledeće minimalne uslove:</p> <p>1.1. da budu državljanii Republike Kosovo;</p> <p>1.2. da imaju važeću diplomu pravnog fakulteta priznatu zakonima Kosova;</p> <p>1.3. da su položili pravosudni ispit priznat važećim zakonima Kosova;</p> <p>1.4. da ima visoku profesionalnu reputaciju i lični integritet;</p> <p>1.5. da nisu osuđeni za krivično delo definisano važećim zakonima;</p>
---	--	--

